



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1197_08_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 12.09.2014.

në seancën e mbajtur më datë 03 tetor 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit me shifër DFE – 9036011 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1197_08_14 i datës 12.09.2014.

Arsyetim

Me datë 28.02.2013 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë bërë pranimin teknik të njehsorit elektrik nr. 1100229137 me gjendje TL=000999 kWh (tarifa e lartë) dhe TU= 001142 kWh (tarifa e ulët). Ekipi i KEK-ut ka vulosur njehsorin elektrik me vulë distributive numër: K000131231 dhe K000131263, si dhe K.P.O. me vulë numër K000131299.

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 04.12.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën nëntor 2013 me **7029 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **426.86€**.

Me datë 06.12.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë. Pas kësaj punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 19.12.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 1100229137, ku gjendja e njehsorit elektrik në momentin e inspektimit ka qenë: TL=005135 kWh dhe TU=006861 kWh.

Me datë 27.12.2013 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike dhe listave të leximit për periudhën përkatëse 2013 duke bërë korrigjimin e faturave për periudhën 03/2013 deri më 11/2013 në vlerë **-36.22€**.



Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 20.01.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke bërë kontestimin e faturave të energjisë elektrike nga muaji mars deri në muajin nëntor të vitit 2013 për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë nga ana e KEK dhe më pas nga KEDS. DMK pas kësaj ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe me datë 26.08.2014 ka nxjerrë vendim duke e **refuzuar** ankesën e konsumatorit me arsyetimin se KEDS ka vepruar konform dispozitave të nenit 23 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji duke bërë përmirësimet e nevojshme për shkak të faturimit dhe leximit jo të saktë në periudhat kontestuese.

Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se është i pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së, dhe ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të rishqyrtojë edhe njëherë këtë vendim dhe gjithashtu të ndëshkohen punëtorët e KEDS për neglizhencën 8 mujore që kanë bërë në leximin e pikës matëse si dhe ka kërkuar që për pjesën e mbetur të borgjtit ta paguaj me këste dhe të jem i kursyer nga çyçja e energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 03 tetor 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e konsumatorit nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka bërë gabimisht vlerësimin e provave gjatë vendosjes së kësaj çështje. Lidhur me neglizhencën e bërë nga ana e punëtorëve të autorizuar të KEDS dhe ndëshkimet e tyre, Bordi i ZRRE-së nuk merret me ndëshkimet e punëtorëve të KEDS-it pasi që për punën dhe aktivitetet e tyre merret kompania KEDS, gjithashtu për lëshimet e tilla janë paraparë edhe dispozita ligjore për korrigjimin e gabimeve të bëra ku me këtë rast është marr për bazë dispozita e nenit 23 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji dhe mbi bazën e kësaj është bërë korrigjimi nga ana e KEDS. Çështje tjetër e theksuar në ankesën e konsumatorit që kërkon t'i ndahet në këste borxhi i mbetur. Bordi ka vlerësuar se konsumatori nuk ka saktësuar se për cilën vlerë të borxhit bëhet fjalë nga ana e konsumatorit, a pajtohet me borxhin e përcaktuar me vendimin e DMK nëse jo, atëherë ka qenë dashur të saktësohet se për cilën vlerë dhe të ofrohen prova për këtë çështje. Në ligjet dhe rregullat e sektorit të energjisë nuk saktësohet çështja e pagesës së borxheve të energjisë elektrike në këste, kjo mund të bëhet vetëm me shprehjen e vullnetit të palëve kontraktuese në këtë rast KEDS – konsumator.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë shtesë me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 03.10.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1197_08_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar